

FONDI VULLNETAR I PENSIONIT “Credins Pension”

PASQYRAT FINANCIARE

30 Shtator 2019

1. Pasqyra e aseteve të fondit të pensionit
 Emri i fondit të pensionit: **Fondi Vullnetar i Pensionit "Credins Pensions"**
 Emri i shoqërisë administruese: **Credins Invest**
 Për periudhën: **30.09.2019**

	Lek	Lek
	30/09/2019	31/12/2018
1. Mjete monetare në arkë dhe llogari rrjedhëse	105,716,131.79	7,600,118.97
2. Investime (2a+2b+2c+2d)	665,385,048.59	561,152,084.11
2.a Letra borxhi të blera në emetimin e parë	477,919,216.94	405,743,376.24
2b. Investime financiare me vlerë të drejtë ndërmjet fitimit dhe humbjes		
2c. Investime financiare të vlefshme për shitje	-	61,087,123.43
2d. Investime financiare të mbajtura deri në maturim	477,919,216.94	344,656,252.81
2a. Letra borxhi të blera të blera në treg sekondar	187,465,831.65	155,408,707.87
2b. Investime financiare me vlerë të drejtë ndërmjet fitimit dhe humbjes		
2c. Investime financiare të vlefshme për shitje	61,932,377.71	27,401,643.90
2d. Investime financiare të mbajtura deri në maturim	125,533,453.94	128,007,063.97
3. Llogari të arkëtueshme	11,274,456.83	13,582,953.93
3a. Të arkëtueshme nga shitja e letrave me vlerë		
3b. Të arkëtueshme nga shoqëritë administruese		
3c. Të arkëtueshme nga depozitari		
3d. Parapagime		
3e. Të arkëtueshme nga ndryshimi i anëtarësisë		
3f. Të arkëtueshme të tjera	11,274,456.83	13,582,953.93
A (1+2+3) TOTALI I AKTIVEVE	782,375,637.21	582,335,157.01
4. Detyrime nga investimi në letrat me vlerë		
5. Detyrime nga investimi në depozita		
6. Detyrime ndaj shoqërisë administruese	1,864,636.38	1,468,022.36
7. Detyrime ndaj depozitarit		
8. Detyrime nga ndryshimi i anëtarësisë	68,704.57	274,108.60
9. Pagesa të shtyra dhe të ardhura të marra në avancë		
10. Detyrime të tjera	1,000.00	2,000.00
B (4+5+6+7+8+9+10) TOTALI I DETYRIMEVE	1,934,340.95	1,744,130.96
C (A-B) AKTIVET NETO TE FONDIT TE PENSIONIT	780,441,296.26	580,591,026.05
D Numri i kuotave të fondit të pensionit të emetuara	533,969.9581	412,991.7038
E (C/D) AKTIVET NETO PËR KUOTË TË FONDIT TË PENSIONIT	1,461.5828	1,405.8176

2. Pasqyra e veprimtarisë të fondit të pensionit
 Emri i fondit të pensionit: **Fondi Vullnetar i Pensionit “Credins Pensions”**
 Emri i shoqërisë administruese: **Credins Invest**
 Për periudhën: **30.09.2019**

		30/09/2019	30/09/2018
Nr.	Zerat		
	TË ARDHURA NGA INVESTIMET		
1	Fitime të realizuara nga shitja e investimeve në letra me vlerë	8,131,141.85	494.86
2	Të ardhura nga interesat	31,157,177.47	22,470,725.13
3	Diferenca pozitive të kurseve të këmbimit nga mjetet monetare		
4	Të ardhura nga dividendët		
5	Te ardhura te tjera	378.80	
A (1+2+3+4+5)	TOTALI I TË ARDHURAVE NGA INVESTIMET	39,288,698.12	22,471,219.99
	SHPENZIMET		
6	Humbje të realizuara nga shitja/maturimi investimeve në letra me vlerë	3,254.85	589.68
7	Diferenca negative të kurseve të këmbimit nga mjetet monetare		
8	Tarifa për shoqërinë administruese	14,972,168.20	9,952,350.32
9	Tarifa për depozitarin		
10	Shpenzime të tjera-Amortizim prim (discount) AFS te shitura *	96,212.14	80.18
B (6+7+8+9+10)	TOTALI I SHPENZIMEVE	15,071,635.19	9,953,020.18
C (A-B)	FITIMI (HUMBJA) NETO NGA INVESTIMET, +/-	24,217,062.93	12,518,199.81
	FITIMI (HUMBJA) E PAREALIZUAR NGA INVESTIMET NË LETRA ME VLERË		
d1	Fitimi (humbja) e parealizuar nga investimet në letra me vlerë, +/-		
d2	Ndryshime neto prej kurseve të këmbimit në investimet në letra me vlerë		
d3	Amortizimi i primit/diskontit të aktiveve me afat maturimi fiks dhe te vlefshme për shitje	-327,326.52	-192,505.16
d4	Zhvlerësim i aktiveve		
D (d1+d2+d3+d4)	TOTALI I FITIMEVE (HUMBJEVE) TË PAREALIZUARA NGA INVESTIMET NË LETRA ME VLERË, +/-	-327,326.52	-192,505.16
E (C+D)	RRITJA (ZVOGËLIMI) NETO I AKTIVEVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT	23,889,736.41	12,325,694.65

3. Pasqyra e ndryshimeve në asetet neto
 Emri i fondit të pensionit: *Fondi Vullnetar i Pensionit*
“Credins Pensions”
 Emri i shoqërisë administruese: *Credins Invest*
 Për periudhën: **30.09.2019**

		30/09/2019	31/12/2018
	Zërat		
	RRITJA (ZVOGËLIMI) I AKTIVEVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT		
1	Fitimi (Humbja) neto nga investimet, +/-	24,217,062.93	17,667,452.85
2	Totali i fitimeve (humbjeve) të përealizuara nga investimet në letra me vlerë, +/-	-327,326.52	-182,095.79
3	Rivlerësimi i aktiveve financiare të vlefshme për shitje *	1,226,531.11	452,016.27
A (1+2+3)	RRITJA (ZVOGËLIMI) I AKTIVEVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT	25,116,267.52	17,937,373.33
4	Kontribute nga anëtarët e fondit	198,088,691.26	236,464,719.35
5	Tërheqje për shkak të tërheqje parakohshme	-12,492,136.69	-11,160,834.69
6	Tërheqje për pagesat e përfitimeve të pensionit	-10,634,740.71	-5,727,109.26
7	Tërheqje për transferime	-227,811.17	-2,207,211.45
B (4-5-6-7)	RRITJA (ZVOGËLIMI) NË TOTAL NGA TRANSAKSIONET ME KUOTAT E PENSIONIT, +/-	174,734,002.69	217,369,563.95
C (A+B)	RRITJA (ZVOGËLIMI) NË TOTAL I AKTIVEVE NETO, +/-	199,850,270.21	235,306,937.28
D	AKTIVET NETO		
8	Në fillim të periudhës	580,591,026.05	345,284,088.77
9	Në fund të periudhës	780,441,296.26	580,591,026.05
	NUMRI I KUOTAVE TË PENSIONIT		
10	Kuota të pensionit të emtuara mbi bazën e kontributeve	137,150.9121	171,725.9222
11	Kuota të pensionit të tërhequra terheqje te parakohëshme	-8,670.1865	-8,073.3319
12	Kuota të pensionit të tërhequra për shkak të pagesave të përfitimeve të pensionit	-7,341.9770	-4,127.8959
13	Kuota të pensionit të tërhequra për transferime	-160.4943	-1,583.9372
E (10-11-12-13)	NUMRI I KUOTAVE TË PENSIONIT	120,978.2543	157,940.7572

4. Pasqyra mbi kuotat e fondit të pensionit

Emri i fondit të pensionit: **Fondi Vullnetar i Pensionit “Credins Pensions”**

Emri i shoqërisë administruese: **Credins Invest**

Për periudhën: **30.09.2019**

Nr.	Lloji	Numri i kuotave të fondit	Aktivet e fondit	Aktive për kuotë
1	Në fillim të periudhës	412,991.7038	580,591,026.05	1,405.8176
2	Emetuar gjatë periudhës	137,150.9121	198,088,691.26	1,444.3119
3	Tërhequr parakohe nga gjendja e fondit	-8,670.1865	-12,492,136.69	1,440.8152
4	Tërhequr për shkak të pagesave të përfitimeve të pensionit	-7,341.9770	-10,634,740.71	1,448.4846
5	Tërheqje për transferime	-160.4943	-227,811.17	1,419.4346
6	Totali në fund të periudhës	533,969.9581	780,441,296.26	1,461.5828

5.Pasqyra e strukturës së investimeve 5.2 Obligacionet
 Emri i fondit të pensionit: **Fondi Vullnetar i Pensionit “Credins Pensions”**
 Emri i shoqërisë administruese: **Credins Invest**

Lloji	Vlera nominale	Kostoja e prokuruar	Vlera në datën e raportimit	Pjesëmarrja në pronën e emetuesit, %	Pjesëmarrja në totalin e aktiveve të fondit, %
AL0021NF5Y19 / AL0021NF5Y19	2,200,000.00	2,199,958.67	2,256,260.86	0.11	0.29
AL0022NF5V20 / AL0022NF5V20	2,500,000.00	2,499,660.82	2,522,757.59	0.13	0.32
AL0023NF5Y20 / AL0023NF5Y20	9,000,000.00	9,001,088.37	9,235,058.52	0.36	1.18
AL0025NF5Y20 / AL0025NF5Y20	2,000,000.00	1,999,822.60	2,049,763.14	0.06	0.26
AL0027NF5Y21 / AL0027NF5Y21	2,500,000.00	2,500,058.06	2,515,995.59	0.05	0.32
AL0028NF5Y21 / AL0028NF5Y21	8,500,000.00	8,499,220.25	8,674,219.98	0.15	1.11
AL0029NF5Y22 / AL0029NF5Y22	6,900,000.00	6,898,751.95	6,953,980.72	0.11	0.89
*Obligacione 5 vjeçare	33,600,000.00	33,598,560.72	34,208,036.40	0.97	4.37
AL0007NF7Y20 / AL0007NF7Y20	1,000,000.00	1,000,038.22	1,021,240.19	0.03	0.13
AL0007NF7Y20 / AL0007NF7Y20	1,500,000.00	1,500,041.17	1,531,849.99	0.04	0.20
AL0008NF7Y21 / AL0008NF7Y21	1,600,000.00	1,600,298.02	1,604,581.75	0.05	0.21
AL0009NF7Y21 / AL0009NF7Y21	2,100,000.00	2,100,337.50	2,146,177.42	0.09	0.27
AL0010NF7Y21 / AL0010NF7Y21	2,900,000.00	2,899,689.62	2,908,820.25	0.12	0.37
AL0011NF7Y21 / AL0011NF7Y21	1,700,000.00	1,700,070.51	1,740,688.05	0.03	0.22
AL0012NF7Y22 / AL0012NF7Y22	2,000,000.00	2,000,492.78	2,006,397.62	0.04	0.26
AL0013NF7Y22 / AL0013NF7Y22	7,200,000.00	7,201,618.28	7,361,432.12	0.36	0.94
AL0014NF7Y22 / AL0014NF7Y22	3,700,000.00	3,699,850.17	3,710,730.60	0.15	0.47
AL0015NF7Y22 / AL0015NF7Y22	5,600,000.00	5,600,766.07	5,709,052.03	0.22	0.73
AL0016NF7Y23 / AL0016NF7Y23	8,400,000.00	8,401,249.57	8,416,692.82	0.28	1.08
AL0017NF7Y23 /	6,200,000.00	5,925,976.82	5,976,799.08	0.21	0.76

AL0017NF7Y23					
AL0017NF7Y23 / AL0017NF7Y23	11,000,000.00	10,999,511.70	11,021,169.04	0.37	1.41
AL0018NF7Y24 / AL0018NF7Y24	14,200,000.00	14,201,708.98	14,255,996.61	0.57	1.82
AL0019NF7Y24 / AL0019NF7Y24	15,400,000.00	15,400,738.91	15,672,419.04	0.40	2.00
ALTN7Y130620 / ALTN7Y130620	2,000,000.00	2,000,177.31	2,053,584.51	0.20	0.26
ALTN7Y200920 / ALTN7Y200920	1,500,000.00	1,499,809.55	1,502,770.16	0.08	0.19
ALTN7Y200920 / ALTN7Y200920	2,000,000.00	1,999,723.85	2,003,680.64	0.10	0.26
<i>*Obbligazione 7 vjeçare</i>	90,000,000.00	89,732,099.03	90,644,081.92	3.34	11.58
AL002NF10Y24 / AL002NF10Y24	2,000,000.00	1,999,909.86	2,033,111.20	0.17	0.26
AL003NF10Y24 / AL003NF10Y24	2,400,000.00	2,400,178.45	2,496,367.09	0.12	0.32
AL004NF10Y24 / AL004NF10Y24	3,700,000.00	3,701,015.74	3,761,441.24	0.19	0.48
AL005NF10Y24 / AL005NF10Y24	2,600,000.00	2,599,949.62	2,703,830.01	0.13	0.35
AL006NF10Y25 / AL006NF10Y25	5,100,000.00	5,099,655.84	5,185,506.32	0.51	0.66
AL008NF10Y25 / AL008NF10Y25	10,000,000.00	10,003,406.17	10,163,000.76	0.50	1.30
AL009NF10Y25 / AL009NF10Y25	6,600,000.00	6,600,406.67	6,852,887.01	0.26	0.88
AL010NF10Y26 / AL010NF10Y26	4,700,000.00	5,352,150.94	5,367,113.90	0.16	0.69
AL010NF10Y26 / AL010NF10Y26	6,300,000.00	7,057,529.20	7,088,573.06	0.21	0.91
AL010NF10Y26 / AL010NF10Y26	13,400,000.00	15,010,333.18	15,076,448.83	0.45	1.93
AL010NF10Y26 / AL010NF10Y26	13,600,000.00	13,600,302.47	13,810,680.09	0.45	1.77
AL011NF10Y26 / AL011NF10Y26	7,700,000.00	7,701,231.01	7,792,605.82	0.26	1.00
AL012NF10Y26 / AL012NF10Y26	8,000,000.00	7,999,464.03	8,256,614.34	0.32	1.06
AL013NF10Y27 / AL013NF10Y27	7,400,000.00	7,536,362.26	7,644,128.80	0.25	0.98
AL013NF10Y27 / AL013NF10Y27	7,200,000.00	7,245,084.81	7,356,234.49	0.24	0.94
AL013NF10Y27 / AL013NF10Y27	12,700,000.00	12,698,897.06	12,900,679.96	0.42	1.65
AL014NF10Y27 / AL014NF10Y27	17,300,000.00	16,773,015.99	17,357,510.73	0.43	2.22
AL014NF10Y27 / AL014NF10Y27	41,600,000.00	40,182,404.89	41,598,105.39	1.04	5.32
AL014NF10Y27 / AL014NF10Y27	4,400,000.00	4,400,156.17	4,539,496.62	0.11	0.58

AL015NF10Y28 / AL015NF10Y28	7,700,000.00	7,789,364.72	7,899,875.47	0.22	1.01
AL015NF10Y28 / AL015NF10Y28	6,900,000.00	6,910,830.41	7,014,122.13	0.20	0.90
AL015NF10Y28 / AL015NF10Y28	7,900,000.00	7,909,102.57	8,027,565.66	0.23	1.03
AL015NF10Y28 / AL015NF10Y28	3,000,000.00	2,999,871.55	3,045,076.43	0.09	0.39
AL015NF10Y28 / AL015NF10Y28	55,000,000.00	54,997,506.86	55,826,271.44	1.57	7.14
AL016NF10Y28 / AL016NF10Y28	5,300,000.00	5,377,053.79	5,553,275.35	0.15	0.71
AL016NF10Y28 / AL016NF10Y28	5,400,000.00	5,465,177.54	5,645,533.37	0.15	0.72
AL016NF10Y28 / AL016NF10Y28	10,700,000.00	10,808,668.64	11,167,280.25	0.31	1.43
AL016NF10Y28 / AL016NF10Y28	7,200,000.00	7,248,958.64	7,491,725.27	0.21	0.96
AL016NF10Y28 / AL016NF10Y28	2,800,000.00	2,800,159.34	2,895,700.07	0.08	0.37
AL017NF10Y28 / AL017NF10Y28	21,700,000.00	22,059,922.00	22,376,994.98	0.87	2.86
AL017NF10Y28 / AL017NF10Y28	9,400,000.00	9,402,351.52	9,548,609.29	0.38	1.22
AL018NF10Y29 / AL018NF10Y29	15,100,000.00	15,854,975.32	16,008,642.41	0.38	2.05
AL018NF10Y29 / AL018NF10Y29	59,200,000.00	60,317,669.70	62,644,257.71	1.48	8.01
AL019NF10Y29 / AL019NF10Y29	140,000,000.0 0	140,000,000.0 0	141,766,925.4 0	4.67	18.12
AL001NF10Y23 / AL001NF10Y23	2,800,000.00	2,800,101.03	2,908,348.04	0.05	0.37
<i>*Obbligazione 10 vjeçare</i>	536,800,000.0 0	540,703,167.9 9	551,804,538.9 3	17.26	70.59
TOTALI BRENDA VENDIT	660,400,000.0 0	664,033,827.7 4	676,656,657.2 5	21.57	86.54

5.5 Pasqyra e strukturës së investimeve-Investime të tjera
5.5 Investime të tjera

Emri i fondit të pensionit: **Fondi Vullnetar i Pensionit “Credins Pension”**

Emri i shoqërisë administruese: **Credins Invest**

Për periudhën: 30.09.2019

Lloji	Vlera në datën e raportimit	Pjesëmarrja në totalin e aktiveve të fondit %
Mjete monetare dhe ekuivalente të mjeteve monetare (brenda vendit)	1,687,427.22	0.22
Aktive të tjera (brenda vendit)	68,704.57	0.01
TOTALI BRENDA VENDIT	1,756,131.79	0.22
Lloji	Vlera në datën e raportimit	Pjesëmarrja në totalin e aktiveve të fondit %
DEP0072, Tirana Bank 30.09.2019-07.10.2019, 1,0%	103,960,000.00	13.29
TOTALI BRENDA VENDIT	103,960,000.00	13.29

6. Pasqyra e fitimeve (humbjeve) të realizuara te fondit

Emri i fondit të pensionit: **Fondi Vullnetar i Pensionit “Credins Pensions”**

Emri i shoqërisë administruese: **Credins Invest**

Për periudhën: **30.09.2019**

Data e maturimit	Letra me vlerë të maturuara	Vlera nominale	Vlera kontabël	Çmimi i shitjes/maturimit	Fitimi (Humbja e realizuar)
1	2	3	4	5	6 (5-4)
14.09.2019	ALTN7Y140919	7,100,000	7,099,220.84	7,100,000	779.16
18.06.2019	ALTN7Y180619	9,500,000	9,502,790.12	9,500,000	-2,790.12
10.02.2019	AL0018NF5Y19	2,000,000	1,999,658.39	2,000,000	341.61
08.05.2019	AL0019NF5Y19	2,000,000	2,000,453.25	2,000,000	-453.25
07.01.2019	AL0038NF3Y19	4,200,000	4,200,011.48	4,200,000	-11.48
06.06.2019	AL017NF10Y28*	85,900,000	87,940,538.92	96,070,560	8,130,021.08
	Obligacione të Qeverisë		112,742,673.00	120,870,560.00	8,127,887.00

7. Pasqyra e fitimeve (humbjeve) të perealizuara te fondit

Letra me vlerë	Data e blerjes	Shpenzimet e blerjes	Vlera e tregut	Fitimi i perealizuar nga ndryshimi I cmimit	Ndryshimi neto ne vleren e investimit nga kursi i këmbimit	Amortizimi I primit/ diskauntit te aktiveve me afat maturimi fiks	Dif Riv
ALTN7Y130620	13.06.2013	2,000,177.31	1,999,371.18	0	0	(806.12)	0
ALTN7Y200920	03.10.2013	1,499,809.55	1,499,695.16	0	0	(114.39)	0
ALTN7Y200920	20.09.2013	1,999,723.85	1,999,580.64	0	0	(143.21)	0
AL0007NF7Y20	27.12.2013	1,000,038.22	999,717.96	0	0	(320.26)	0
AL0007NF7Y20	16.12.2013	1,500,041.17	1,499,566.66	0	0	(474.51)	0
AL0008NF7Y21	17.03.2014	1,600,298.02	1,600,167.53	0	0	(130.49)	0
AL0009NF7Y21	16.06.2014	2,100,337.50	2,099,646.08	0	0	(691.42)	0
AL001NF10Y23	29.10.2013	2,800,101.03	2,799,711.93	0	0	(389.10)	0
AL0010NF7Y21	15.09.2014	2,899,689.62	2,899,431.50	0	0	(258.12)	0
AL0011NF7Y21	09.12.2014	1,700,070.51	1,699,540.96	0	0	(529.55)	0
AL0012NF7Y22	16.03.2015	2,000,492.78	2,000,323.18	0	0	(169.60)	0
AL0013NF7Y22	16.06.2015	7,201,618.28	7,199,192.12	0	0	(2,426.17)	0
AL0014NF7Y22	16.09.2015	3,699,850.17	3,699,536.04	0	0	(314.13)	0
AL0015NF7Y22	16.12.2015	5,600,766.07	5,599,204.92	0	0	(1,561.15)	0
AL0016NF7Y23	16.03.2016	8,401,249.57	8,400,686.15	0	0	(563.42)	0
AL0017NF7Y23	15.09.2016	10,999,511.70	10,998,756.54	0	0	(755.16)	0
AL0017NF7Y23	07.12.2016	5,925,976.82	5,964,166.58	0	0	38,189.76	0
AL0018NF7Y24	03.03.2017	14,201,708.98	14,200,190.61	0	0	(1,518.37)	0
AL0019NF7Y24	01.06.2017	15,400,738.91	15,398,038.10	0	0	(2,700.81)	0
AL002NF10Y24	24.01.2014	1,999,909.86	1,999,194.54	0	0	(715.32)	0
AL0021NF5Y19	10.11.2014	2,199,958.67	2,199,623.08	0	0	(335.59)	0
AL0022NF5Y20	09.02.2015	2,499,660.82	2,499,205.51	0	0	(455.32)	0
AL0023NF5Y20	04.05.2015	9,001,088.37	8,999,633.52	0	0	(1,454.85)	0
AL0025NF5Y20	09.11.2015	1,999,822.60	1,999,473.14	0	0	(349.47)	0
AL0027NF5Y21	05.08.2016	2,500,058.06	2,499,762.95	0	0	(295.11)	0
AL0028NF5Y21	08.11.2016	8,499,220.25	8,498,199.15	0	0	(1,021.10)	0
AL0029NF5Y22	03.02.2017	6,898,751.95	6,897,716.97	0	0	(1,034.98)	0
AL003NF10Y24	25.04.2014	2,400,178.45	2,399,853.76	0	0	(324.69)	0
AL004NF10Y24	25.07.2014	3,701,015.74	3,699,646.10	0	0	(1,369.64)	0
AL005NF10Y24	24.10.2014	2,599,949.62	2,599,613.34	0	0	(336.27)	0
AL006NF10Y25	23.01.2015	5,099,655.84	5,097,708.40	0	0	(1,947.44)	0
AL008NF10Y25	24.07.2015	10,003,406.17	9,999,834.09	0	0	(3,572.08)	0
AL009NF10Y25	23.10.2015	6,600,406.67	6,599,593.68	0	0	(812.99)	0

Letra me vlerë	Data e blerjes	Shpenzimet e blerjes	Vlera e tregut	Fitimi i përealizuar nga ndryshimi I cmimit	Ndryshimi neto në vlerën e investimit nga kursi i këmbimit	Amortizimi I primit/ diskauntit të aktiveve me afat maturimi fiks	Dif Riv
AL010NF10Y26	18.01.2016	13,600,302.47	13,595,800.09	0	0	(4,502.39)	0
AL010NF10Y26	14.04.2016	15,010,333.18	14,864,728.83	0	0	(145,604.35)	0
AL011NF10Y26	15.07.2016	7,701,231.01	7,699,564.16	0	0	(1,666.85)	0
AL012NF10Y26	07.10.2016	7,999,464.03	7,999,036.56	0	0	(427.46)	0
AL013NF10Y27	04.07.2017	7,536,362.26	7,524,248.80	0	0	(12,113.46)	0
AL014NF10Y27	09.10.2017	40,182,404.89	40,278,865.39	0	0	96,460.50	0
AL014NF10Y27	03.04.2017	4,400,156.17	4,399,961.62	0	0	(194.55)	0
AL015NF10Y28	11.01.2018	54,997,506.86	54,981,410.33	0	0	(16,096.53)	0
AL016NF10Y28	03.04.2018	2,800,159.34	2,800,021.73	0	0	(137.61)	0
AL017NF10Y28	04.07.2018	9,402,351.52	9,399,462.62	0	0	(2,888.90)	0
AL018NF10Y29	04.04.2019	15,854,975.32	15,827,064.91	0	0	(27,910.41)	0
AL019NF10Y29	04.07.2019	140,000,000.00	140,003,469.85	0	0	3,469.85	0
Obligacione të Qeverisë të mbajtura në maturim ,blerë në treg primar		478,020,530.16	477,919,216.94	0.00	0.00	(101,313.23)	0.00
AL010NF10Y26	20.06.2016	5,352,150.94	5,292,853.90	0	0	(59,297.05)	0
AL010NF10Y26	17.05.2016	7,057,529.20	6,989,033.06	0	0	(68,496.13)	0
AL013NF10Y27	08.03.2017	7,245,084.81	7,239,594.49	0	0	(5,490.33)	0
AL013NF10Y27	09.01.2017	12,698,897.06	12,694,939.96	0	0	(3,957.11)	0
AL014NF10Y27	06.12.2017	16,773,015.99	16,808,884.48	0	0	35,868.49	0
AL015NF10Y28	12.03.2018	7,789,364.72	7,781,594.91	0	0	(7,769.81)	0
AL015NF10Y28	01.02.2018	7,909,102.57	7,906,212.88	0	0	(2,889.69)	0
AL015NF10Y28	09.02.2018	6,910,830.41	6,908,130.46	0	0	(2,699.95)	0
AL015NF10Y28	12.01.2018	2,999,871.55	2,998,993.09	0	0	(878.45)	0
AL016NF10Y28	25.05.2018	5,465,177.54	5,461,010.87	0	0	(4,166.67)	0
AL016NF10Y28	05.06.2018	5,377,053.79	5,372,169.93	0	0	(4,883.86)	0
AL016NF10Y28	06.04.2018	7,248,958.64	7,245,695.27	0	0	(3,263.37)	0
AL016NF10Y28	09.05.2018	10,808,668.64	10,801,652.33	0	0	(7,016.31)	0
AL017NF10Y28	13.08.2018	22,059,922.00	22,032,688.31	0	0	(27,233.69)	0
Obligacione të Qeverisë të mbajtura në maturim ,blerë në treg sekondar		125,695,627.86	125,533,453.94	0.00	0.00	(162,173.92)	0.00
AL018NF10Y29	07.03.2019	13,062,629.70	13,286,168.86	0	0	-13,968.67	237,507.83
AL018NF10Y29	14.01.2019	33,603,120.00	34,627,731.46	0	0	-34,219.24	1,058,830.70
AL018NF10Y29	11.02.2019	13,651,920.00	14,018,477.39	0	0	-15,651.46	382,208.85
Obligacione të Qeverisë të mbajtura në AfS ,blerë në treg sekondar		60,317,669.70	61,932,377.71	0	0	-63,839.37	1,678,547.38
TOTALI		664,033,827.73	665,385,048.59	0	0	-327,326.52	0

						Diference Rivleresimi AFS	1,678,547.38
						Rimarrje rivleresimi (2018) per AFS te shitura	(452,016.27)
						<u>Teprice rivleresimi 30.09.2019</u>	1,226,531.11

* *Vlera kontabel e obligacionit te shitur AL017NF10Y28 06.06.2019* 87,940,538.9 leke;
Vlera kontabel AL017NF10Y28 31.12.2018 88,488,767.33 leke

(88,036,751.06 vlera kontabel jo e rivleresuar+ 452,016.27 leke rivleresimi me 31.12.2018)

Shpenzime te amortizimit primit te AFS shitura -96212.14 leke (diference 87,940,538.92 leke -88,036,751.06 leke);

8. Pasqyra e kontributeve të anëtarëve te fondit

Emri i fondit të pensionit: **Fondi Vullnetar i Pensionit “Credins Pensions”**

Emri i shoqërisë administruese: **Credins Invest**

Për periudhën: **30.09.2019**

Gjendja e Kontributeve te derdhura 01.01.2019 - 30.09.2019 (ne leke)	ne lekë
Nga Anetare vullnetare	90,882,554.89
Punonjes + Punedhenes	107,206,136.37
Totali	198,088,691.26
Punonjes + Punedhenes:	
Kontributet e Punedhenesve	63,599,931.99
Kontributet e Punonjesve	43,606,204.38
Totali	107,206,136.37
Gjendja e Kontributeve te derdhura 30.09.2019 (ne leke)	ne lekë
Nga Anetare vullnetare	361,543,378.64
Punonjes + Punedhenes	418,062,134.66
Totali	779,605,513.30
Punonjes + Punedhenes:	
Kontributet e Punedhenesve	254,503,680.49
Kontributet e Punonjesve	163,558,454.17
Totali	418,062,134.66

1. Informacione të përgjithshme

Mbështetur në Ligjin nr 10197 datë 12 Dhjetor 2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar” në 13 Dhjetor 2011, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (“AMF”) bazuar në Vendimin Nr. 173, miratoi “Fondi i Pensionit Vullnetar “Credins Pension”” (“Fondi”).

Shoqëria, me emërtimin e ri “Credins Invest sh.a.” – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive aktualisht administron vetëm një fond pensioni vullnetar të quajtur Fondi i Pensionit Vullnetar “Credins Pension”, i cili nuk është entitet ligjor dhe nuk ka personalitet juridik.

Me vendimin Nr. 91, datë 18 .07.2012 të Bordit të AMF u miratua Tirana Bank sh.a. për të vepruar si depozitar i Fondit “Credins Pension”.

Shoqëria dhe Depozitari janë të detyruar të mbajnë të ndara aktivet, veprimet dhe regjistrimet e veta, nga aktivet, veprimet, dhe regjistrimet e Fondit, për këtë arsye edhe raportimet për shoqërinë dhe Fondin paraqiten të ndara.

2. Bazat e përgatitjes

a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

b) Bazat e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

c) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në monedhën shqiptare “Lek”, e cila është monedha funksionale. Përveç rasteve kur është shënuar ndryshe, informacioni financiar është paraqitur në Lek.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të vlerësuara. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Politikat kontabël të vendosura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare dhe janë aplikuar në mënyrë të qëndrueshme nga Fondi.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

a) Instrumentat Financiare

Njohja dhe çregjistrimi

Aktivet dhe detyrimet financiare njihen kur Fondi bëhet palë e dispozitive kontraktuale të instrumentit financiar.

Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose kur aktivet financiare transferohen dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet transferohen.

Një detyrim financiar çregjistrohet kur shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon.

Klasifikimi dhe matja fillestare e aktiveve financiare

Përveç atyre të arkëtueshme tregtare që nuk përmbajnë një përbërës të konsiderueshëm financimi dhe maten me çmimin e transaksionit në përputhje me SNRF 15, të gjitha aktivet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit (aty ku është e aplikueshme).

Aktivet financiare, të ndryshme nga ato të përcaktuara dhe efektive si instrumenta mbrojtës, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- Me kosto të amortizuar
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL)
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI).

Klasifikimi përcaktohet nga:

- modeli i biznesit i njësisë ekonomike për menaxhimin e aktivit financiar
- karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivit financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me aktivet financiare që njihen në fitim ose humbje paraqiten brenda shpenzimeve financiare, të ardhurave financiare ose zërave të tjerë financiarë, me përjashtim të shpenzimeve zhvlerësimit të të arkëtueshmet tregtare të cilat përfshihen brenda shpenzimeve të tjera.

Matja e mëpasshme e aktiveve financiare

i) Aktivet financiare me kosto të amortizuar

Aktivet financiare maten me koston e amortizuar nëse plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë paracaktuara si FVTPL):

- ato mbahen në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e mjeteve financiare dhe mbledhja e flukseve monetare kontraktuale
- kushtet kontraktuale të aktiveve financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar

Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, shumica e të arkëtueshmeve të tjera, si dhe obligacioneve të listuara që më parë ishin klasifikuar si të mbajtura deri në maturim sipas SNK 39 bëjnë pjesë në këtë kategori të instrumenteve financiare.

ii) Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL)

Aktivitetet financiare që mbahen në një model biznesi të ndryshëm nga "mbajtja për të mbledhur" ose "mbajtja për të mbledhur dhe shitur" kategorizohen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes. Më tej, pavarësisht nga modeli i biznesit, aktivitetet financiare, flukset monetare kontraktuale të të cilave nuk janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit kalsifikohen në kategorinë FVTPL. Të gjitha instrumentet financiare derivative bien në këtë kategori, përveç atyre të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtës, për të cilët zbatohen kërkesat e kontabilitetit mbrojtës (shih më poshtë).

Kjo kategori gjithashtu përmban një investimet në kapital. Aktivitetet në këtë kategori maten me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje.

Vlera e drejtë e aktiveve financiare në këtë kategori përcaktohet duke iu referuar transaksioneve aktive të tregut ose duke përdorur një teknikë vlerësimi ku nuk ekziston një treg aktiv. Sipas kërkesave të SNRF 9 nuk lejohet mbajtja me kosto e këtyre aktiveve.

iii) Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI)

Shoqëria llogarit aktivitetet financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse FVOCI nëse aktivitetet plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- ato mbahen në një model biznesi objektiv i të cilit është "mbajtja për të mbledhur dhe shitur" dhe
- kushtet kontraktuale të aktiveve financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar.

Çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) do të riciklohet pas çregjistrimit të aktivitetit.

iv) Aktivet financiare të klasifikuara si të vlefshme për shitje (AFS) sipas SNK 39 (periudhat krahasuese)

Aktivitetet financiare të vlefshme për shitje AFS janë aktive financiare jo-derivative të cilat janë të përcaktuara në këtë kategori ose nuk kualifikohen për përfshirje në ndonjë nga kategoritë e tjera të aktiveve financiare (FVTPL) ose të mbajtura deri në maturim dhe kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme).

Të gjitha aktivitetet financiare të vlefshme për shitje AFS maten me vlerën e drejtë. Fitimet dhe humbjet njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse brenda kapitalit neto, përveç të ardhurave nga interesi dhe dividendët, humbjet nga zhvlerësimi dhe diferencat në valutë të huaj mbi aktivitetet monetare, të cilat njihen në fitim ose humbje. Kur aktivi është shitur ose zhvlerësuar, fitimi ose humbja kumulative e njohur në kapitalin neto është riklasifikuar nga rezerva e kapitalit neto në fitim ose humbje. Interesi është llogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe dividendët janë njohur në fitim ose humbje brenda të ardhurave financiare.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 përdorin më shumë informacione të ardhshme për të njohur humbjet e pritshme të kreditit - 'modelin e humbjeve të pritshme të kreditit (ECL)'. Kjo zëvendëson SNK 39 'modelin e humbjeve të ndodhura'.

Instrumentet financiare në kuadër të kërkesave të reja përfshinin kreditë dhe aktivitetet e tjera financiare të borxhit të matura me koston e amortizuar, llogaritë e arkëtueshme, aktivitetet financiare të matura me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, aktivitetet e kontraktuara të njohura dhe të matur sipas SNRF 15 dhe

angazhimeve të huasë dhe disa kontratave të garancisë financiare (për emetuesin) që nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Njohja e humbjeve të kreditit nuk varet me prej identifikimit të një ngjarje individuale të humbjes së kredisë mbi baze individuale. Në vend të kësaj, Shoqëria konsideron një gamë më të gjerë informacioni gjatë vlerësimit të rrezikut të kredisë dhe matjen e humbjeve të pritshme të kreditit, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetura që ndikojnë në arkëtueshmërinë e pritshme të flukseve monetare të ardhshme të instrumentit.

Në zbatimin e kësaj qasjeje të ardhshme, bëhet një dallim midis:

- instrumentet financiare që nuk janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare ose që kanë rrezik të ulët të kredisë ('Faza 1') dhe
- instrumentet financiare që janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kredisë i të cilit nuk është i ulët ('Faza 2').

'Faza 3' do të mbulonte aktivet financiare që kanë tregues objektive të zhvlerësimit në datën e raportimit.

Humbjet e pritshme të kreditit '12 - mujore' njihen për kategorinë e parë, ndërsa 'humbjet e pritshme të kreditit përgjatë jetës së instrumentit' njihen për kategorinë e dytë.

Matja e humbjeve të pritshme të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

Shoqëria nuk ka identifikuar dhe njohur zhvlerësim për aktivet financiare me 31 dhjetor 2018.

i) Zhvlerësimi i mëparshëm i aktiveve financiare sipas SNK 39

Në vitin paraprak, zhvlerësimi i aktiveve financiare është bazuar në modelin e humbjeve të ndodhura. Aktivet financiare individualisht të rëndësishme testoheshin për zhvlerësim kur kishin tregues për rënie në vlerë. Aktivi financiar, të cilat nuk ishin individualisht të rëndësishme rishikoheshin për zhvlerësim në grupe të përcaktuara në bayë karakteristikav të rrezikut të kreditit të përbashkët. Shoqëria nuk kishte identifikuar dhe njohur zhvlerësim për aktivet financiare deri me 31 dhjetor 2017.

ii) Klasifikimi dhe matja e detyrimeve financiare

Duke qenë se kontabilizimi i detyrimeve financiare mbetet kryesisht i njëjtë sipas SNRF 9 krahasuar me SNK 39, detyrimet financiare të Fondit nuk janë ndikuar nga adoptimi i SNRF 9.

Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe, kur është e aplikueshme, përshtaten për kostot e transaksionit, përveç nëse Fondi ka përcaktuar një detyrim financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Më pas, detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç derivativave dhe detyrimeve financiare të përcaktuara në FVTPL, të cilat mbahen më pas me vlerën e drejtë me fitimet ose humbjet të njohura në fitim ose humbje (përveç instrumenteve financiare derivative të cilat janë të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse).

Të gjitha pagesat lidhur me interesin dhe, nëse është e zbatueshme, ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti që raportohen në fitim ose humbje përfshihen në kostot financiare ose të ardhurat financiare.

Instrumentet financiare derivative dhe kontabiliteti mbrojtës

Shoqëria zbaton kërkesat e reja të kontabilitetit mbrojtës në SNRF 9 prospektivisht. Të gjitha marrëdhëniet mbrojtëse që ishin marrëdhënie mbrojtëse sipas SNK 39 në datën e raportimit më 31 dhjetor 2017 plotësojnë kriteret e SNRF 9 për kontabilitetin mbrojtës më 1 janar 2018 dhe prandaj konsiderohen si marrëdhënie mbrojtëse të vazhdueshme.

Instrumentet financiare derivative llogariten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes (FVTPL) me përjashtim të derivateve të përcaktuara si instrumente mbrojtës në marrëdhëniet mbrojtëse të flukseve monetare, të cilat kërkojnë një trajtim të veçantë kontabël. Për t'u kualifikuar për kontabilitetin mbrojtës, marrëdhënia mbrojtëse duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e mëposhtme:

- Ekziston një marrëdhënie ekonomike midis zërit të mbrojtur dhe instrumentit mbrojtës
- Efekti i rrezikut të kredisë nuk dominon ndryshimet e vlerës që rezultojnë nga ajo ekonomike
- Raporti i mbrojtjes i marrëdhënies mbrojtëse është i njëjtë me atë që rezulton nga sasia e elementit të mbrojtur që njësia ekonomike aktualisht mbron dhe sasia e instrumentit mbrojtës që njësia ekonomike aktualisht përdor për të mbrojtur atë sasi të elementit të mbrojtur.

Të gjitha instrumentet financiare derivative të përdorura për kontabilitetin mbrojtës njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe raportohen më pas me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar.

Në masën që mbrojtja është efektive, ndryshimet në vlerën e drejtë të derivativëve të përcaktuar si instrumente mbrojtës në mbrojtjen e fluksit të mjeteve monetare njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe përfshihen në rezervën mbrojtëse të fluksit të mjeteve monetare në kapitalin neto. Çdo ineficence në marrëdhënien mbrojtëse njihet menjëherë në fitim ose humbje.

Në kohën kur elementi i mbrojtur ndikon në fitimin ose humbjen, çdo fitim ose humbje e njohur më parë në të ardhurat e tjera përmbledhëse riklasifikohet nga kapitali neto në fitim ose humbje dhe paraqitet si një riklasifikim brenda të ardhurave të tjera përmbledhëse. Megjithatë, nëse një aktiv ose detyrim jofinanciar është njohur si rezultat i transaksionit të mbrojtur, fitimet dhe humbjet e njohura më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse përfshihen në matjen fillestare të elementit të mbrojtur.

Nëse një transaksion i ardhshëm nuk pritet të ndodhë, çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse bartet menjëherë në fitim ose humbje. Nëse marrëdhënia mbrojtëse pushon të përmbushë kushtet e efektivitetit, kontabiliteti mbrojtës ndërpritet dhe fitimi ose humbja në fjalë mbahen në rezervën e kapitalit neto derisa të ndodhë transaksioni i ardhshëm.

b) Mjete monetare dhe ekuivalentë me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to përfshijnë gjendjet monetare në arkë, paratë e vendosura në banka dhe investime mjaft likuide afat-shkurtra me maturitet më pak ose deri në tre muaj nga momenti i blerjes.

c) Depozita me afat

Depozitat me afat janë vendosur në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën e principalit dhe janë klasifikuar si të tilla ato me maturitet më shumë se tre muaj. Interesi është përlllogaritur në baza rritëse dhe interesi i arkëtueshëm është pasqyruar në të arkëtueshme të tjera.

d) Letra me vlerë

Letrat me vlerë janë tituj borxhi të cilët Fondi ka qëllimin dhe mundësinë t'i mbajë deri në maturim dhe klasifikohen si aktive për tu mbajtur deri në maturim. Investimet të cilat kanë pagesa fikse apo të përcaktuara dhe të cilat janë me qëllim për t'u mbajtur në maturim maten me kosto të amortizuar, minus parashikimi për zhvlerësim në vlerë. Kosto e amortizuar është përlllogaritur duke marrë në llogari ndonje zbritje apo prim ne

blerje. Primi dhe zbritja e investimeve të mbajtura deri në maturim amortizohen në mënyrë sistematike deri në maturim duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe regjistrohen në të ardhura nga interesat.

e) Investime letra me vlerë me qëllime tregtimi

Letrat me vlerë të mbajtura për qëllime tregtimi maten me vlerën e drejtë. Çdo ndryshim i vlerës së tregut njihet në fitim ose humbje sipas percaktimeve të politikave kontabël

f) Letra me vlerë të vlefshme për shitje

Investimet evlefshme për shitje janë investime joderivative, të cilat nuk klasifikohen në ndonjë kategori tjetër të aktiveve financiare. Investimet në kapital, të cilat nuk janë të kuotuar dhe vlera e drejtë nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, maten me kosto.

Mjetet e tjera të disponueshme për shitje mbahen me vlerën e tyre të drejtë. Të ardhurat nga interesi regjistrohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave sipas metodës së interesit efektiv. Ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse deri në momentin që letra me vlerë shitet ose zhvlerësohet, dhe balanca në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse njihen në fitim ose humbje.

g) Fitim/ humbjet e realizuara

Fitim/humbjet e realizuara krijohen në rastin e shitjes/maturimit të letrave me vlerë me çmim të ndryshëm nga cmimi i blerjes së letrave me vlerë dhe efektet transferohen në pasqyrën e tyre ardhura/shpenzimeve në momentin kur ndodhim.

h) Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme të tjera janë mbajtur me kosto të amortizuara.

i) Vlera neto e aktiveve të Fondit

Vlera neto e aktiveve të Fondit është e barabartë me totalin e aktiveve minus detyrimet e Fondit.

j) Të ardhurat nga interesa në letra me vlerë

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat e investimeve njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në bazë të metodës së interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare përgjatë jetës së aktivitetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme për një periudhë më të shkurtër) në vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset në momentin fillestar të njohjes së aktivitetit, ose detyrimit financiar dhe nuk ndryshohet në periudhat e mëtejshme.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të marra, kostot e transaksionit, zbritjet apo primet të cilat janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit janë kosto shtesë të lidhura me blerjen, emetimin ose reregjistrimin e aktivitetit, ose detyrimit financiar. Të ardhurat nga interesat e obligacioneve të thesarit të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave pasqyrojnë interesin e aktiveve financiare të investuara të Fondit.

k) Tarifa e administrimit

Fondi detyrohet t'i paguajë Shoqërisë një tarifë prej 3% (në bazë vjetore) të Vlerës Neto të Aktiveve, shpenzim ky për Fondin i cili përlllogaritet në bazë ditore.

4. POLITIKA E INVESTIMEVE E FONDIT TE PENSIONIT VULLNETAR “CREDINS PENSION”

Politika e Investimeve (PI) përbën dokumentin kryesor që kontrollon strategjinë e investimeve të Fondit. PI së bashku me Politikën e Menaxhimit të Riskut (PMR) përbëjnë dy shtyllat kryesore të Komitetit të Investimit për të administruar dhe realizuar objektivat kryesorë të fondit. Fondi do të menaxhohet në përputhje me të gjithë ligjet dhe rregulloret jo të limituara vetëm me Ligjin Nr. 10197 datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar”. Qëllimi i PI është të asistojë Komitetin e Investimit për të monitoruar, vlerësuar dhe rishikuar politikën e investimit të Fondit.

Elementët kryesorë të PI janë:

- Përcaktimi i qartë i ndarjeve të përgjegjësive të Këshillit të Administrimit, Komitetit të Investimit, Pjesëmarrësve të Fondit (kontribuesit), dhe Depozitarit;
- Përcaktimi i Objektiveve dhe i kufizimeve të investimit;
- Përcaktimi i alokimit të aseteve të fondit;
- Vlerësimi i performancës së fondit në krahasim me “benchmark-un” e përcaktuar;
- Vendosja e procedurës së komunikimit midis Këshillit të Administrimit, Depozitarit, dhe Komitetit të Investimeve.

4. POLITIKA E INVESTIMEVE E FONDIT TE PENSIONIT VULLNETAR “CREDINS PENSION”

5. Kufiri i Investimeve të lejuara

Kufiri i investimeve të lejuara percaktohet në rregulloren “Per aktivet e lejuara, kufizimet dhe kufirin maksimal të investimit të fondit të pensionit”, miratuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare me vendimin e Bordit nr 1, date 28.01.2010 dhe ndryshuar me vendimin e Bordit 109, date 18.10.2010.

Sipas rregullores, asetet e fondit nuk mund të investohen më shumë se:

- 100% në obligacione, bono thesari dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga Republika e Shqipërisë;
- 20% në depozita bankare në të njëjtën bankë;
- 30% në letra borxhi të klasifikuara si BBB ose më të lartë, sipas Standard & Poor’s ose Fitch, Baa3 ose më të lartë sipas Moody’s, ose BBB (e ulët) ose më të lartë sipas DBRS (Dominion Bond Rating Service), por jo më shumë se 10 %, në një emetues të vetëm;
- 30% në aksione ose në kuota të fondeve të investimit të licencuara në një shtet anëtar të BE-së dhe:
 - që asetet e tyre investohen në indekset në vijim: CAC 40, DAX, FTSE 100, S&P 500, Mesatarja Industriale e Doë Jones, Nikkei 225 (Japoneze), Sensex (Indiane), All Ordinaries (Australiane) dhe Indeksi Hang Seng (Hong Kong); ose
 - që asetet e tyre investohen në obligacione, bono thesari dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga shtetet anëtare të BE-së;
- 100% në obligacione, bono thesari ose në letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane e Investimeve dhe Banka Botërore;
- 100% në obligacione, bono thesari dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga shtetet anëtare të BE-së ose të OECD-se ose nga bankat qendrore përkatëse, por:
 - jo më shumë se 30% në një emetues të vetëm.
 - kufiri rritet deri në 100% në një emetues të vetëm, pas miratimit nga AMF, sipas argumenteve të dhëna për një politikë të tillë investimi.

Alokimi Strategjik i Aseteve

Pjesa më e madhe e alokimit të asetëve i përket bonove të thesarit dhe obligacioneve të qeverisë si në tabelën më poshtë:

Klasa e asetëve	Minimumi	Maksimumi
Bono thesari dhe obligacione të emetuara dhe të garantuara nga Qeveria e RSH.	70%	100%
Cash dhe ekuivalente të saj	1 %	15%
Bono thesari dhe obligacione të shteteve anëtare të BE të denominuara në monedhën EUR	0%	30%
Depozita në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë	0%	20%

Politika Fiskale dhe ajo Monetare ndikojnë ndjeshëm në normat e interesit të bonove të thesarit. Si të tilla ato do të monitorohen vazhdimisht për të përcaktuar impaktin e tyre në asetet e fondit.

Alokimi i asetëve do rishikohet nga Komiteti i Investimit të paktën një herë në vit. Rishikimi nënkupton vlerësimin e kushteve të tregut dhe jo domosdoshmërisht ndryshimin e alokimit të asetëve.

6. Administrimi i Riskut

Individët përballen me tre risqe të rëndësishme kur mendojnë për zgjedhjen e kursimeve dhe investimeve për pension:

(i) risku i tregut financiar,

(ii) risku i jetëgjatësisë,

(iii) risku i moskursimit të duhur apo i shpenzimeve të tepërta që sjellin mosplotësimin e nevojave për të ardhura gjatë fazës së pensionit. Pjesë e riskut të tretë është dhe risku nga inflacioni.

Risku i Tregut Financiar

Risku i tregjeve financiare apo luhatshmëria e tregjeve të kapitalit mund të shkaktojë fluktacion të vlerës së portofolit në afatshkurtër edhe pse në afatgjatë vlera e portofolit mund të rritet. Deri me 30 Shtator 2018, portofoli i investimit konsiston në obligacione të mbajtura deri në maturim, i cili nuk ndikohet nga luhatshmëria e cmimeve të tregut. Nëse tregu bie apo ndryshimet ndodhin në momentin që klienti kalon nga faza e akumulimit në atë të pensionit (faza e tërheqjes), atëherë portofoli i individit mund të mos i përballojë tërheqjet e ardhshme sistematike. Rrjedhimisht, portofoli mund të mos gjenerojë dot të ardhura të mjaftueshme për stilin e jetesës së dëshiruar të individit ose thjesht mund të përfundojnë flukset monetare përpara se individit të vdesë. Investuesit mund ta injorojnë riskun financiar duke supozuar një normë të qëndrueshme të kthimit nga portofoli i tyre i pensionit.

Menaxhimi i riskut financiar në shoqëri është një proces që fillon me identifikimin e risqeve, vendosjen e limiteve të ekspozimit, matjen e vazhdueshme të ekspozimeve, monitorimin e limiteve, dhe përfundon me axhustimin e ekspozimit brenda niveleve të kërkuara. Shoqëria përdor instrumenta derivative në fazën e rregullimit vetëm për qëllime mbrojtje. Masat e rrezikut të tregut për rrezikun e normave të interesit është “modified duration”, e cila mat sensitivitetin e vlerës së tregut kundrejt ndryshimeve të normave të tregut.

Me poshtë ndodhet pozicioni i portofolit me 30 Shtator 2019, kohëzgjatja e modifikuar dhe skenaret e rritjes/uljes me 100 bp.

Fondi i Pensionit-30.09.2019	
Skenari	Humbje/Fitimi
rritje 100bp	(37,783,651.39)
ulje 100bp	37,783,651.39

	30 Shtator 2019 (Lekë)
Pa vonesa dhe të pazhvlerësuar	
Bono dhe Obligacion të RSH(B1 - sipas Moody's)	676,656,657.20
Vlera kontabël	676,656,657.20
Pozicioni (Leke)	Kohezgjatja e Modifikuar
676,656,657.20	5.58

Risku i Jetëgjatësisë

Të jetuarit më gjatë nënkupton nevojën e zotërimit të më shumë burimeve për të përballuar kërkesat afatgjatë për shpenzim. Risku i jetëgjatësisë, është mundësia që vlera e portofolit (kursimet e akumuluar) të ketë një jetëgjatësi shumë më të vogël sesa jetëgjatësia e individit gjatë periudhës së pensionit. Investuesit janë të gatshëm të paguajnë një prim sigurimi për të shmangur këtë lloj risku. “Të përvitshmet” janë një produkt që konvertojnë investimin e akumuluar në të ardhura (benefite) që i paguhen klientit gjatë gjithë jetës (periudhës së

pensionit) së mbetur. Përfitimi përgjatë jetës sigurohet duke e shtrirë riskun e jetëgjatësisë mbi një numër të madh të përvitshmesh dhe duke bërë supozime të kujdesshme dhe konservative mbi normën e kthimit që do të fitohet mbi asetet.

Kursimi i pamjaftueshëm

Investuesit mund të mos kursejnë aq sa për të financuar mjaftueshëm portofolet e pensionit. Skema me kontribute të përcaktuara kërkon mjaft këshillim financiar si përgjatë fazës së akumulimit ashtu edhe përgjatë fazës së tërheqjeve. Sfidat që mbart me vete skema e kontributeve të përcaktuara nënkupton që klientët të zgjedhin alokimin e duhur të aseteve si dhe produkte që do të sigurojnë një pension të përshtatshëm përgjatë jetës. Shoqëria përpiqet të sigurojë këshillim financiar cilësor ndaj klientëve të saj.

7. Shënime për zëra të pasqyrave

	30 Shtator 2019	31 Dhjetor 2018
Llogari në banka në Lek	1,756,131.79	1,000,118.97
Depozite	103,960,000.00	6,600,000.00
	105,716,131.79	7,600,118.97

	30 Shtator 2019	31 Dhjetor 2018
Interesa të përlllogaritura obligacione-Amortised Cost	10,559,728.61	10,759,450.28
Interesa të përlllogaritura obligacione -FVOCI	711,880.00	2,823,246.67
Interesa të depozitave dhe llogarive rrjedhëse	2,848.22	256.98
	11,274,456.83	13,582,953.93

Detyrimi ndaj Shoqërisë Administruese

Detyrimi ndaj Shoqërisë Administruese paraqet vlerën e tarifës administrimi e përlllogaritur në bazë ditore të Vlerës Neto të Aktiveve të Fondit, përkatësisht, shpenzimi për muajin Shtator 2019.

	30 Shtator 2019	30 Shtator 2018
Të ardhura nga obligacione	31,047,565.97	22,459,450.44
Të ardhura nga interesa të depozitave dhe llogarive rrjedhëse	109,611.50	11,274.69
Total	31,157,177.47	22,470,725.12

Përgatiti

Armira ÇITOZI
Drejtore e Financës dhe Kontabilitetit

Miratoi

Estela KOÇI
Administratore e Përgjithshme

